



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## THIRRJE E HAPUR

### Shkëmbim ndërkombëtar për gazetarët investigativë 2021

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të mbështesë tre gazetarë investigativë nga Shqipëria për të marrë pjesë në një shkëmbim me kolegë ndërkombëtarë të vlerësuar për punën e tyre investigative. Në vitin 2019, shkëmbimi tregoi u organizua gjatë Konferencës Globale të Gazetarisë Investigative në Hamburg të Gjermanisë, me përfshirjen e “Der Spiegel”-it. Në vitin 2020, udhëtimi nuk ishte i mundur për shkak të pandemisë dhe gazetarëve iu dhuruan laptopë. Këtë vit, për shkak të ndryshimit të vazhdueshëm të kufizimeve të udhëtimit, detajet e shkëmbimit do të njoftohen në një fazë të mëvonshme.

Duke synuar përzgjedhjen e pjesëmarrësve, ne po hapim një konkurs, ku ftojmë gazetarët investigativë të aplikojnë.

Ne kërkojmë artikujt më të mirë investigativë në shtyp, TV, radio dhe media online **mbi luftën kundër korrupsionit** në Shqipëri.

#### Kriteret:

- Gazetarët nga Shqipëria, që punojnë në Shqipëri;
- Artikull/kronikë investigative botuar apo transmetuar në Shqipëri ndërmjet 1 nëntorit 2020 dhe 31 tetorit 2021;
- Çdo aplikant mund të paraqesë vetëm **një** artikull.

#### Aplikimi duhet të përfshijë:

- Curriculum Vitae të gazetarit;
- Letër motivimi për pjesëmarrjen në shkëmbimin ndërkombëtar;
- Bashkëngjitur artikullin apo kronikën, filmin, dokumentarin investigativ ose linkun e tij.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen, deri më 31 tetor 2021, me email në adresën [mdual@osce.org](mailto:mdual@osce.org)